

VENDIM
Nr. 146, datë 18.9.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BINDI” SHPK.
NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.9.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Bindi” sh.p.k., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Bindi” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pika 4.8, germa “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Bindi” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti